

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1, nenit 20 paragrafi 1 alineja 1 dhe nenit 25 nga Ligji për Nëpunësit Gjyqësor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 43/14, 98/15, 33/15, 06/16 dhe 198/18) dhe Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes, të zbatimit të selektimit administrativ të provimeve, kontrollit të besueshmërisë së dëshmvive dhe intervistës si dhe mënyra e vlerësimit të tyre dhe numri maksimal i pikëve në procedurën e selektimit në varshmëri nga kategoritë e vendeve të punës si dhe çështje të tjera me procedurën për punësim të nëpunësve gjyqësor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 236/18), GJKATA THEMELORE STRUGË, më datë 14.12.2021,

P u b l i k o n

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR - 1/2021

**për punësim të 1 (një) nëpunësit gjyqësor në kohë të pacaktuar,
për vendin e punës si në vijim:**

**1. Kategorija G, niveli G3, Referent gjyqësor – realizues në shkrestore 1 –
(një) realizues – shifra SUD 0101G03001;**

Kushtet e veçanta:

- Më së paku shkollim i lartë apo shkollim i mesëm
- Më së paku 1 vit përvojë pune në profesion
- Njohje aktive të njërës nga tre gjuhët më shpesh të përdorura në Unionin European (anglisht, frangjisht ose gjermanisht) dhe
- Njohja aktive të programeve kompjuteristike për punë në zyrë

Krahas kushteve të veçanta të theksuara, të parapara me Rregulloren për sistematizim dhe organizimin e brendshëm të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Strugë, kandidati duhet t’i plotësojë edhe kushtet e përgjithshme, të përcaktuara në nenin 21 paragrafi 1 nga Ligji për Nëpunësit Gjyqësor, edhe atë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut (nënshtetësija),
- në mënyrë aktive ta përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës (vërtetim mjekësor) dhe
- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimeve (vërtetim nga gjykata).

Rroga bazë neto për vendin e theksuar të punës është: 18.836,00 denarë; Orari i punës nga ora 07:30 deri në ora 15:30, kohëzgjatja javore 40 orë – nga e hëna në të premte, kohëzgjatja e marëdhënies së punës është në kohë të pacaktuar.

Kandidatët janë të detyruar të parashtrojnë fletëparaqitje për punësim dhe dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës në origjinal apo kopje të vërtetuara në Noter.

Në fletëparaqitjen, përkrah dëshmimeve, detyrimisht duhet të përmbahet: emri dhe mbiemri i kandidatit të mbështetura me dëshmi – letërnjoftim, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi i kandidatit, e-mail adresa ose telefoni për kontakt.

Afati për paraqitje është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.

Kushtet e theksuara në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e paraqitjes.

Kandidati i cili ka dhënë të dhëna të rrejshme në fletëparaqitje diskualifikohet nga procedura e mëtutjeshme.

Fletëparaqitjen me dëshmitë, kandidatët janë të detyruar që t'a dorëzojnë drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet postës deri në arhivin e Gjykatës Themelore Strugë, Rr. "JNA" pn, e njëjta mund të gjendet në mënyrë elektronike në internet faqen www.osstruga.mk apo të tërhiqet personalisht në hapsirat e gjykatës.

Koha dhe data e mbajtjes së seleksionimit administrativ, provimit dhe intervistës do të shpallen në internet faqen e Gjykatës Themelore Strugë.

GJYKATA THEMELORE STRUGË